



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 101

Tiranë – E mërkurë, 8 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 1.6.2016	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Astrit Kasneci..... 5715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 1.6.2016	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Andi Tela..... 5715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 1.6.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rishikimi i projektit të zbatimit të fazës së parë të vijës bregdetare të qytetit të Vlorës”..... 5715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 1.6.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i parkut sportiv” Korçë..... 5716
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2565, datë 23.5.2016	Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve portuale, shkaqet e pezullimit apo revokimit të tyre..... 5721

**VENDIM****Nr. 410, datë 1.6.2016****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. ASTRIT KASNECI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Astrit Kasneci, në masën 3 800 000 (tre milionë e tetëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 411, datë 1.6.2016****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. ANDI TELA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Andi Tela, në masën 2 900 000 (dy milionë e nëntëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 412, datë 1.6.2016****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RISHIKIMI I PROJEKTIT
TË ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË
VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË
VLORËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rishikimi i projektit të zbatimit të fazës së parë të vijës bregdetare të qytetit të Vlorës”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme prej 68 483 455.76 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 68 483 455.76 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet



procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

7. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RISHIKIM I PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS”

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe truall	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera truall dhe ndërtësë	Shënime
1	Lumturi Varfi Vladimir Varfi	8602	36/122/2	250.00		10.903	2.725.750	0,00	2.725.750	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë
2	Lumturi Varfi Vladimir Varfi	8602	36/123/ND		311,00		0,00	12982239	12.982.239	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Urdhër kufizimi
3	Turi Aligjoni Flavia Aligjoni	8602	36/125	299.92	330,00	10.903	3.270.028	13.871.630	17.141.658	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është ndërtësë dykatëshe. Urdhër kufizimi
4	Ilir Bircaj Vasil Bircaj	8602	40/88/ND		713,00		0,00	29.613.299	29.613.299	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Sekuestro konservative
5	Batjar Bazaj Luiza Xhaho	8602	36/191/ND		31,89		0,00	618.577	618.577	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë
6	Posedohet nga Ilir dhe Vasil Bicaj (karburant)	8602			362,00			5.401.933	5.401.933	Kompensimi për efekt shpronësimi të objektit kryhet pasi të jetë paraqitur dokumentacioni i plotë i pronësisë së objektit pranë Bashkisë Vlorë
TOTALI									68.483.455,76	

Në pasurinë nr. 40/89, e llojit “truall”, me pronar “shtet”, shpronësohet objekti mbi truall me leje ndërtimi në posedim nga Ilir dhe Vasil Bicaj.

**VENDIM
Nr. 413, datë 1.6.2016**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I
PARKUT SPORTIV” KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”,

dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i parkut sportiv” Korçë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.



3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme prej 388 140 245 (treqind e tetëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 388 140 245 (treqind e tetëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Korçë.

7. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



TABELA E SHPRONËSIMEVE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I PARKUT SPORTIV”, KORÇË

Numë r rendor	Zona kadastrale	I regjistruar pranë ZVRPP-së me nr.	Volum	Faqe	Emër, atësi, mbiemër	Statusi ligjor i pronës sipas ZVRPP-së Korçë	Parcelë me sipërfaqe (m²)	Ndërtes ë (m²)	Shënime	Truall i cili shpronësohet (m²)	Ndërtesë (m²)	Çmimi lekë/m²	Vlera e objektit	Vlera e truallit	Shuma totale e shpronësimit
1	8561	1/1	21	24	Shteti	Truall	4523.3		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	4523.3		0	0	0	0
2	8561	1/3	16	141	Shteti	Trotuar	337.5		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	337.5		0	0	0	0
3	8561	1/4	16	142	Shteti	Trotuar	464.1		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	464.1		0	0	0	0
4	8561	1/5	21	14	Bashkia Korçë	Terren sportiv, Stadiumi	23934.7	323.3	Nuk ka shënime në sektorin D+E	23934.7	323.3				
5	8561	1/6	21	20	Shteti	Trotuar	528.9		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	528.9		0	0	0	0
6	8561	1/7	16	201	Shteti	Trotuar	1012.8		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	1012.8		0	0	0	0
7	8561	1/11	16	227	Shteti	Rrugë	4746.8		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	4746.8		0	0	0	0
8	8561	1/12	16	230	Shteti	Truall	2974.5	2258	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	2974.5	2258	0	0	0	0
9	8561	1/14	Inventari i Bashkisë		Bashkia Korçë	Lulishte	5171			5171					
10	8561	1/19	21	120	Shteti	Truall	1208.4		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	1208.4		0	0	0	0
11	8561	1/22	18	22	Shteti	Truall	13811.2		Nuk ka shënime në sektorin D+E	13811.2		0	0	0	0
12	8561	1/23	18	23	Shteti	Truall	3581.3	250	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	3581.3	250	0	0	0	0
13	8561	1/25	18	28	Shteti	Rrugë	8553.5		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	8553.5		0	0	0	0
14	8561	1/31	16	237	Niko Albert Kaciroti+br	Truall	620		Nuk ka shënime në sektorin D+E	620		8537	5,292,940		5,292,940
15	8561	1/36	Inventari i Bashkisë		Bashkia Korçë, Harqet	Ndërtesë	4237				4237				
16	8561	1/38	18	134	Shteti	Truall	957.6		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	957.6		0	0	0	0
17	8561	1/39	21	178	Shteti	Truall	8156.5		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	8156.5		0	0	0	0
18	8561	1/41	19	2	Shteti	Truall	792.6		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	792.6		0	0	0	0
19	8561	1/42	21	138	Bashkia Korçë	Truall, fusha stërvitore	6346.7		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	6346.7		0	0	0	0
20	8561	1/51	21	133	Shtet	Truall	11001.6		Nuk ka shënime në sektorin D+E	11001.6		0	0	0	0
21	8561	1/272	16	80	Petro Lako+br	Truall	990		Nuk ka shënime në sektorin D+E	990		8537	8,451,630		8,451,630
22	8561	1/287	16	171	Jorgo Ligor Baze	Truall	542.7		Nuk ka shënime në sektorin D+E	542.7		8537	4,633,030		4,633,030
23	8561	1/293	16	219	Niko Albert Kaciroti+br	Truall	880		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	880		8537	7,512,560		7,512,560
24	8561	1/294	22	229	Viktor Kaciroti+br	Truall	418		Nuk ka shënime në sektorin D+E	418		8537	3,568,466		3,568,466



25	8561	1/314	37	19	Thoma Furxhi+br	Truall	1062	Nuk ka shënime në sektorin D+E	1062	8537	9,066,294	9,066,294
26	8561	1/315	37	20	Thoma Furxhi+br	Truall	703	Nuk ka shënime në sektorin D+E	703	8537	6,001,511	6,001,511
27	8561	1/316	37	21	Thoma Furxhi+br	Truall	6200	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	6200	8537	52,929,400	52,929,400
28	8561	1/323	19	19	Diana Tomi Mancka	Truall	1127	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	285	8537	2,433,045	2,433,045
29	8561	1/331	18	238	Ligor Drenesku+br	Truall	875	Nuk ka shënime në sektorin D+E	875	8537	7,469,875	7,469,875
30	8561	1/332	18	239	Ligor Drenesku+br	Truall	3728	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	3728	8537	31,825,936	31,825,936
31	8561	1/336	19	22	Vangjel Vladimir Joti	Truall	375	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	338	8537	2,885,506	2,885,506
32	8561	1/339	19	71	Vangjel Stillo+br	Truall	1300	Nuk ka shënime në sektorin D+E	1300	8537	11,098,100	11,098,100
33	8561	1/361	22	219	Kosta Ropi Mano+br	Truall	877	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	877	8537	7,486,949	7,486,949
34	8561	1/362	22	215	Petraç Stillo+br	Truall	1136	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	1136	8537	9,698,032	9,698,032
35	8561	1/364	22	217	Zhaneta Qafzezi+br	Truall	1136	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	1136	8537	9,698,032	9,698,032
36	8561	1/365	22	220	Vasil Kapurani	Truall	200	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	200	8537	1,707,400	1,707,400
37	8561	1/366	22	221	Kosta Ropi Mano+br	Truall	60	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	60	8537	512,220	512,220
38	8561	1/382	19	23	Teuta Vladimir Peristeri	Truall	375	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	256	8537	2,185,472	2,185,472
39	8561	1/383	19	24	Arben Valdimir Joti	Truall	375	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	222	8537	1,895,214	1,895,214
40	8561	1/384	20	138	Stavri Gago Bardhi	Truall	280	Ka shënime tek sek. E	280	8537	2,390,360	2,390,360
41	8561	1/399	24	72	Pavlina Nuke+br	Truall	942	Vijon v. 42 f. 14	942	8537	8,041,854	8,041,854
42	8561	1/407	18	197	Vangjel Krati Stillo	Truall	1990	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	1990	8537	16,988,630	16,988,630
43	8561	1/408	22	72	Viktor Kristaq Kacirati+br	Truall	836	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	836	8537	7,136,932	7,136,932
44	8561	1/413	31	152	Anesti Stillo+br	Truall	4900	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	4900	8537	41,831,300	41,831,300
45	8561	1/414	31	153	Vangjel Stillo+br	Truall	2000	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	2000	8537	17,074,000	17,074,000
46	8561	1/416	26	9	Anesti Adhami	Truall	284	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	284	8537	2,424,508	2,424,508
47	8561	1/417	26	10	Zinovia Jovan Zguro	Truall	284	Nuk ka shënime në sektorin D+E	284	8537	2,424,508	2,424,508
48	8561	1/418	26	11	Dhimitraq Jovan Stillo	Truall	284	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	284	8537	2,424,508	2,424,508
49	8561	1/419	26	12	Donika Jovan Mile	Truall	284	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	284	8537	2,424,508	2,424,508
50	8561	1/538	15	60	Shteti	Shesh	89.3	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	89.3			
51	8561	1/547	27	229	Shteti	Shesh	24.4	Nuk ka shënime në sektorin D+ E	24.4			
52	8561	1/554	29	71	Shteti	Rrugë	1707.4	Vijon v. 45 f. 88-v. 45 f. 89	1707.4			



53	8561	1/560	20	230	Shteti	Trotuar	137.3		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	137.3					
54	8561	1/561	20	249	Shteti	Trotuar	102		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	102					
55	8561	1/562	13	193	Shteti	Trotuar	192.2		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	192.2					
56	8561	1/563	34	70	Shteti	Trotuar	461.1		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	461.1					
57	8561	1/580	33	106	Shteti	Truall	20.1		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	20.1	0		0	0	
58	8561	1/581	33	105	Shteti	Truall	1033.4	180.8	Ka shënime tek sek. D	1033.4	180.8	0		0	0
59	8561	1/638	37	10	Niko Albert Kacirati+br	Truall	5300		Nuk ka shënime në sektorin D+E	5300	8537		45,246,100	45,246,100	
60	8561	1/639	37	11	Shteti	Truall	194		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	194	0		0	0	
61	8561	1/750	41	204	Klea Harilla Sevo, Perikli Harilla, Meri Vasillaq Duli (Shqau), Thoma Vasillaq Shqau, Marica Pistuli, Edmond Pistuli	Truall	2350		Indeksi i hartës KO-J-8. Pajisur me C.P. datë 2.5.2012. Në përshkrimin e veçantë ka shënim: 018459 urdhër i brendshëm, VKM nr. 672, datë 15.10.2014 shpronësohet pronari për sip. 350 m² Shënime në seksionet e tjera nuk ka	2350	8537		20,061,950	20,061,950	
62	8561	1/751	41	203	Klea Harilla Sevo, Perikli Harilla, Meri Vasillaq Duli (Shqau), Thoma Vasillaq Shqau, Marica Pistuli, Edmond Pistuli	Truall	300		Indeksi i hartës KO-J-8. Pajisur me C.P. datë 2.5.2012. Shënime në seksionet e tjera nuk ka	300	8537		2,561,100	2,561,100	
63	8561	1/753	42	19	Pavlina Nuke+br	Truall	10078.5		Nuk ka shënime në sektorin D+E	1320	8537		11,268,840	11,268,840	
64	8561	1/848	45	89	Shteti	Rrugë	1677.4		Nuk ka shënime në sektorin D+ E	830					0
65	8561	1/849	45	90	Sofika Sotir, Petraq Sotir, Zhaneta Sotir, Arjan Sotir, Viktoria Fani	Truall	557		Indeksi i hartës KO-I-9. Pajisur me C.P. datë 23.7.2013. Shënime në seksionet e tjera nuk ka	557	8537		4,755,109	4,755,109	
66	8561	1/850	45	91	Shtet	Truall	11375.7			11375.7	0		0	0	
67	8561	1/35	18	115	Shteti	Truall	14931.7		Nuk ka shënime në sektorin D+E	14932.7	0		0	0	
68	8561	1/367-ND	22	230	Mariela Albert Kaçiroti, Gjergji Burda	Ndërtesë 3 kt		321.6	Nuk ka shënime në sektorin D+E		0	14,734,426	0	0	
TOTALI															
SIPËRFAQJA TRUALL SHTET										34942	0	14734425.6	0		
SIPËRFAQJA TRUALL SHTET (PRONAR I PAVËRTETUAR)										59630.2	8537				
SIPËRFAQJA TRUALL PRIVATE										43739.7	8537		373,405,819	373,405,819	
SIPËRFAQJA NDËRTESA PRIVATE												14,734,426			
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT														388,140,245	

**UDHËZIM****Nr. 2565, datë 23.5.2016****MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE,
PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË
VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË
SHËRBIMEVE PORTUALE, SHKAQET E
PEZULLIMIT APO REVOKIMIT TË
TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 18, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, me qëllim rregullimin, disiplinimin dhe lehtësimin e veprimtarisë që kërkohet të ushtrohet nga operatorët në fushën e shërbimeve portuale,

UDHËZOJ:**KREU I
TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Objekti**

Ky udhëzim përcakton kushtet për pajisjen e personave fizikë/juridikë me licencë në fushën e shërbimeve portuale dhe afatet e vlefshmërisë së licencave, si dhe kushtet e pezullimit apo revokimit të tyre.

**Neni 2
Përkufizime**

Për qëllimin e këtij udhëzimi, jepen termat e unifikuar me termat e përdoruar në legjislacionin kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar në fushën e transportit detar.

1. “Administrata detare” është tërësia e strukturave të angazhuara në fushën e detarisë.

2. “Drejtoria e Përgjithshme Detare” është autoriteti që drejton dhe organizon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar

për fushën e detarisë, të ratifikuar me ligj nga Republika e Shqipërisë.

3. “E drejta e zhvillimit të veprimtarisë në transportin detar” është e drejta që fiton një pronar ose operator mjeti lundrues për të kryer transport detar.

4. “Licencë për ushtrim veprimtarie në fushën e transportit detar” është akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë dhe të ushtrojë veprimtarinë në transportin detar mbi bazën e procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim.

5. “Ministri”, ministri përgjegjës për transportin detar.

6. “Ministria”, ministria përgjegjëse për transportin detar.

7. “Mjet lundrues” është ai mjet lundrues i certifikuar nga shoqëritë klasifikuese përkatëse dhe është i aftë për të kryer një shërbim në transportin detar.

8. “Ormexhimi” është shërbimi që kryhet nga operatorë të licencuar për të mbajtur të fiksuar një mjet lundrues me kalatën, gjatë kryerjes së operacioneve të ngarkim-shkarkimit apo shërbimeve të tjera të nevojshme për anijen.

9. “Persona juridikë/fizikë në fushën e transportit detar” janë persona të regjistruar si të tillë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me objekt veprimtarie sipas aktiviteteve në fushën e transportit detar.

10. “Pilotimi” është shërbimi i këshillimit që jepet, nga piloti i licencuar, kapitenit që drejton anijen në lundrim, kalim ose manovrim, pavarësisht nëse kjo këshillë jepet në bordin e anijes ose me anë të komunikimit nga një anije tjetër.

11. “QKB”, Qendra Kombëtare e Biznesit.

12. “Shërbime portuale” janë veprimtaritë që lidhen me mbërritjen dhe nisjen e mjeteve lundruese, si edhe me lëvizjen e pasagjerëve e të mallrave brenda dhe jashtë porteve që kryhen nga persona juridikë/fizikë të licencuar për këto aktivitete në territoret e porteve detare.

13. “Stacionet e shërbimit të pajisjeve të sigurimit të jetës në det” është shërbimi që kryhet nga operatorë të licencuar për mirëmbajtjen në anije të pajisjeve dhe mjeteve të shpëtimit.

14. “Survejimi i mjeteve lundruese” është shërbimi që kryhet nga operatorë të licencuar, të cilët mund të delegohen nga autoritetet përkatëse të administratës detare apo pronarët e anijeve, për



të kryer inspektime dhe survejime në mjetet lundruese dhe dhënien e rekomandimeve për të kryer riparime.

15. “Tërheqja e mbetjeve nga anijet” është shërbimi që jepet nga operatorët e licencuar për tërheqjen e mbetjeve të ngurta dhe vajore nga anijet në zbatim të Konventës MARPOL dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.

KREU II

VEPRIMTARITË QË LICENCOHEN NË FUSHËN E SHËRBIMEVE PORTUALE DHE AUTORITETI KOMPETENT PËR LËSHIMIN E TYRE

Neni 3

Veprimtaritë që licencohen

Veprimtaritë në fushën e “Shërbimeve portuale” të transportit detar që janë subjekt licencimi bëjnë pjesë në kategorinë VII.5, si më poshtë:

- Ushtrimi i veprimtarisë së pilotimit, me kodin VII.5.1;
- Ushtrimi i veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto-Romano dhe në radat përkatëse, me kodin VII.5.2;
- Ushtrimi i veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e tjera detare dhe në radat e tyre, me kodin përkatës VII.5.3;
- Ushtrimi i veprimtarisë së Stacionit të Shërbimit të Pajisjeve të Sigurimit të Jetës në Det, me kodin VII.5.4;
- Ushtrimi i veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese, me kodin VII.5.5;
- Ushtrimi i veprimtarisë së ormexhimit me kodin VII.5.6.

Neni 4

Autoriteti kompetent për licencimin

Licencimi i veprimtarive, parashikuar në nenin 3 të këtij udhëzimi trajtohen nëpërmjet QKB-së, sipas grupit të tretë parashikuar në nenet 16 dhe 20, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU III

PROCEDURAT E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE LËSHIMIT TË LICENCEVE

Neni 5

Të përgjithshme

Kërkesat dhe dokumentacioni i personave juridikë/fizikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit detar parashikuar nga neni 3, dorëzohen në QKB.

Dokumentet quhen zyrtarisht të dorëzuara, duke filluar nga data kur personi juridik/fizik ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës në QKB, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në përfundim të procesit të licencimit, personi juridik/fizik pajiset me titullin e licencës dhe aktin e miratimit përkatës.

Afati i licencës për shërbime portuale është:

- Kur aplikon për herë të parë me afat 1-vjeçar (njëvjeçar);
- Në rast përsëritje me afat 3-vjeçar (trevjeçar).

Tarifat e licencimit janë të njëjta me tarifat e përcaktuara në VKM-në nr. 1035, datë 9.7.2008, “Për caktimin e tarifës së licencimit të subjekteve, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në fushën e punimeve të ndërtimit dhe të transportit.

Licenca hyn në fuqi me miratimin dhe publikimin në Regjistrin Kombëtar të Licencave, autorizimeve dhe lejeve.

Neni 6

Dorëzimi i dokumentacionit

Procedurat për dorëzimin e dokumentacionit nga subjektet, pranimin, shqyrtimin dhe licencim nga QKB-ja parashikohen në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 15.5.2013, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.



Dokumentacioni paraqitet në original ose kopje e njehsuar dhe pas verifikimit (skanimit) të gjitha dokumentet i dorëzohen (kthehen) personit fizik/juridik ose personit të autorizuar që paraqet kërkesën.

Ministria, pas shqyrtimit, vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti brenda një afati 20 (njëzet) ditë pune.

Për nevoja teknike, para mbarimit të këtij afati, ministria shpall në regjistrin aplikativ shtyrje afati. Shtyrja e pashpallur në regjistrin aplikativ është e pavlefshme. Shtyrja e afatit bëhet vetëm për shkaqe objektive të pamundësisë për shqyrtimin e kërkesës. Vendimi i shtyrjes sqaron domosdoshmërisht edhe shkaqet që e kanë diktuar atë. Shtyrja mund përdoret vetëm njëherë dhe shtyrja shtesë nuk mund të jetë më e gjatë se vetë afati përkatës i marrjes së vendimit.

Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara më sipër apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i ministrisë.

KREU IV KËRKESAT PËR MARRJEN E LICENCËS PËR SHËRBIME PORTUALE

Neni 7

Për ushtrimin e veprimtarisë së pilotimit

1. Personi fizik për t'u licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së pilotimit duhet të paraqesë pranë autoriteteve dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Formularin e autodeklarimit;
- b) Dëshminë e aftësisë për pilot (certifikatën e pilotit);

c) Një mjet lundrues për shërbim pilotimi, i cili verifikohet nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të mëposhtëm:

i) dëshminë e aftësisë së lundrimit për mjet të vogla. Në rastet kur e merr me qira e shoqëruar nga kontrata noteriale për marrjen me qira, e cila të jetë me afat për jo më pak se 4 vjet dhe të përdoret ekskluzivisht nga subjekti që do të licencohet;

ii) certifikatë nga prodhuesi i mjetit lundrues;

iii) certifikatë e sigurisë e lëshuar nga shoqëria klasifikuese;

iv) dëshminë e aftësisë për drejtuesin e mjetit e lëshuar nga DPD-ja.

d) Mjet të vogël lundrimi për shërbim asistence të vërtetuar nga "Dëshmi e aftësisë së

lundrimit për mjete të vogla", të lëshuar nga DPD-ja. Në rastet kur e merr me qira, e shoqëruar nga kontrata noteriale për marrjen me qira, e cila të jetë me afat për jo më pak se 4 vjet dhe të përdoret ekskluzivisht nga subjekti që do të licencohet;

e) Sistem radioshtacioni që të mundësojnë komunikimin me stacionin qendror dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e hyrje-dalje së mjeteve lundruese në port;

f) Deklaratë që deklaron se ka në përdorim veshje fosforeshente në të cilën të shkruhet fjala "PILOT" dhe më poshtë emrin e operatorit, pajisje personale shpëtimi dhe pajisje të tjera specifike të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, të cilat të jenë të pajisura me certifikata nga prodhuesi;

g) Vendndodhja e aktivitetit të jetë brenda portit ku ushtrohet veprimtaria me shërbim 24/7.

2. Personi juridik që do të licencohet në fushën e pilotimit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, kontratat e punës me pilotët e punësuar, drejtuesit teknikë të kenë eksperiencë mbi 5 vjet si pilotë, si edhe të ketë kualifikimet përkatëse.

Neni 8

Për ushtrimin e veprimtarisë së ormexhimit

1. Personi fizik që do të licencohet në fushën e ormexhimit duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formatin e autodeklarimit;

b) Pasaportën e detarit lëshuar nga DPD-ja;

c) Dokumentin nga DPD-ja që provon eksperiencë pune në det, për të paktën 3 (tre) vjet në veprimtari portuale;

d) Një mjet lundrues për shërbim pilotimi, i cili verifikohet nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të mëposhtëm:

i) dëshmi e aftësisë së lundrimit për mjete të vogla. Në rastet kur e merr me qira, e shoqëruar nga kontrata noteriale për marrjen me qira, e cila të jetë me afat për jo më pak se 4 vjet dhe të përdoret ekskluzivisht nga subjekti që do të licencohet;

ii) certifikatë nga prodhuesi i mjetit lundrues.

iii) certifikatë e sigurisë e lëshuar nga shoqëria klasifikuese;

iv) dëshminë e aftësisë për drejtuesin e mjetit e lëshuar nga DPD-ja.



e) Mjet të vogël lundrimi për shërbim asistence të vërtetuar nga “Dëshmi e aftësisë së lundrimit për mjet të vogla”, të lëshuar nga DPD-ja. Në rastet kur e merr me qira, e shoqëruar nga kontrata noteriale për marrjen me qira, e cila të jetë me afat për jo më pak se 4 vjet dhe të përdoret ekskluzivisht nga subjekti që do të licencohet;

f) Sistem radioshtacioni që të mundësojnë komunikimin me stacionin qendror dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e hyrje-daljeve të mjeteve lundruese në port;

g) Vetëdeklarim sipas legjislacionit në fuqi që ka në përdorim pajisjet e nevojshme personale, si veshje me logon/emrin e subjektit, pajisje dhe veshje fosforeshente, elektrik dore, gaxhaman, radiomarrëse, kaskë dhe pajisje të tjera specifike të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, të cilat të jenë të pajisura me certifikata nga prodhuesi;

h) Raport mjekoligjor që tregon se është i aftë për punë.

2. Personi juridik që do të licencohet në fushën e ormexhimit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, si dhe kontratat e punës me ormexhatorët e punësuar dhe drejtuesit teknikë të kenë eksperiencë mbi 4 vjet në fushën e shërbimeve operacionale, si edhe kualifikimet përkatëse.

Neni 9

Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto-Romano dhe në radat përkatëse

Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e hapura detare të Republikës së Shqipërisë dhe në radat përkatëse, subjektet duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e autodeklarimit;
2. Licencën me kodin III.2.B;
3. Sigurim që të mbulojë dëmet që mund t'u shkaktohen të tretëve gjatë operacioneve të tërheqjes së mbetjeve nga anijet;
4. Genplanin e vendosjes së depove ku do të depozitohen mbetjet e lëngëta të tërhequra nga anijet, i firmosur nga arkitekti/inxhinieri i licencuar dhe kapacitetet e tyre të shoqëruara me aktin e pronësisë/kontratën e qirasë apo kontratën e përdorimit me subjektin që i ka këto

depozita, të shoqëruar me lejen mjedisore të depozitave;

5. Kontratën me bashkitë përkatëse për shkarkimin e mbetjeve të ngurta të tërhequra nga anijet në vendin e paracaktuar nga ato;

6. Dëshminë e pronësisë ose kontratën e qirasë për mjetet tokësore të mëposhtme:

- a) Autobot, copë 3;
- b) Automjet teknologjik të trajtimit të mbetjeve urbane, copë 3;
- c) Automjet vetëshkarkuese për mbledhjen e mbetjeve urbane, copë 1.

Për mjetet tokësore të mësipërme t'i bashkëlidhet formati të autodeklarimit: leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit të fundit teknik, deklaratë që automjetet e mësipërme kanë të vendosur në një vend të dukshëm emrin dhe/ose logon e kompanisë. Për pikën “a” duhet të dorëzojë dhe “certifikatën e miratimit ADR të mjetit”;

7. Dëshminë e pronësisë ose kontratën e qirasë të mjeteve detare të mëposhtme:

a) Një mjet lundrues për grumbullimin e mbetjeve të ngurta dhe vajore, e pajisur me një tanker për grumbullimin e mbeturinave vajore, me kapacitet minimum 2 tonë;

b) Një mjet lundrues për pastrimin e zonave portuale detare dhe radat përkatëse nga vajrat dhe hidrokarburet;

c) Një lançë e vogël.

Për mjetet lundruese, të përcaktuara në pikat “a” dhe “b”, t'i bashkëngjitet formulari të autodeklarimit: “Dëshmi e aftësisë së lundrimit për mjete të vogla”, lëshuar nga DPD-ja, certifikata e sigurisë e lëshuar nga shoqëria klasifikuese.

Deklaratë që personeli është i aftë për menaxhimin e rasteve emergjente dhe luftën kundër zjarrit.

Neni 10

Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e tjera detare dhe në radat e tyre përkatëse

Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e hapura detare të Republikës së Shqipërisë dhe në radat përkatëse, subjektet duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e autodeklarimit;



2. Licencën me kodin III.2.B;

3. Siguracion që të mbulojë dëmet që mund t'u shkaktohen të tretëve gjatë operacioneve të tërheqjes së mbetjeve nga anijet;

4. Genplanin e vendosjes së depove ku do të depozitohen mbetjet e lëngëta të tërhequra nga anijet, i firmosur nga arkitekti/inxhinieri i licencuar dhe kapacitetet e tyre të shoqëruara me aktin e pronësisë/kontratën e qirasë apo kontratën e përdorimit me subjektin që i ka këto depozita, të shoqëruar me lejen mjedisore të depozitave;

5. Kontratën me bashkitë përkatëse për shkarkimin e mbetjeve të ngurta të tërhequra nga anijet në vendin e paracaktuar nga ato;

6. Dëshminë e pronësisë ose kontratën e qirasë për mjetet tokësore të mëposhtme:

a) Një autobot;

b) Një automjet teknologjik të trajtimit të mbetjeve urbane;

c) Një automjet vetëshkarkues për mbledhjen e mbetjeve urbane.

Për mjetet tokësore, të mësipërme t'i bashkëlidhet formatit të autodeklarimit: leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit të fundit teknik, deklaratë që deklaron se automjetet e mësipërme kanë të vendosura në një vend të dukshëm emrin dhe/ose logon e kompanisë. Ndërsa, për pikën “a” duhet të dorëzojë dhe “certifikatën e miratimit ADR të mjetit”.

7. Dëshminë e pronësisë ose kontratën e qirasë të mjeteve detare të mëposhtme:

a) Një mjet lundrues për grumbullimin e mbetjeve të ngurta dhe vajore e pajisur me një tanker për grumbullimin e mbeturinave vajore, me kapacitet minimum 2 tonë;

b) Një mjet lundrues për pastrimin e zonave portuale detare dhe radat përkatëse nga vajrat dhe hidrokarburet;

c) Një lançë e vogël.

Për mjetet lundruese, të përcaktuara në pikat “a” dhe “b”, t'i bashkëngjitet formularit të autodeklarimit: “Dëshmi e aftësisë së lundrimit për mjete të vogla”, lëshuar nga DPD-ja, certifikata e sigurisë e lëshuar nga shoqëria klasifikuese.

Deklaratë që personeli është i aftë për menaxhimin e rasteve emergjente dhe luftën kundër zjarrit.

Neni 11

Për ushtrimin e veprimtarisë së Stacionit të Shërbimit të Pajisjeve të Sigurimit të Jetës në Det

Personat juridikë/fizikë për t'u licencuar për ushtrimin e veprimtarisë të stacionit të shërbimit të pajisjeve të sigurimit të jetës në det duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e autodeklarimit;

2. Kontratën për furnizim periodik nga kompani prodhuese/tregtuese, për pajisjet e brendshme të zadrave;

3. Vërtetimin nga shoqëria klasifikuese, në të cilin të theksohet se plotësohen kushtet e rezolutës A. 761 (18) të IMO-së, “Rekomandime mbi kushtet për aprovimin e një stacioni shërbimi për pajisje shpëtimi me fryrje”, certifikatën e stacionit të shërbimit nga një shoqëri prodhuese dhe certifikatën e një shoqërie prodhuese për personelit që do të punojë në stacionin e shërbimit;

4. Dokumentet e pronësisë mbi objektin ose kontratën e qiramarrjes së noterizuar (stacioni i shërbimit) shoqëruar me genplanin, i firmosur nga inxhinieri/arkitekti i licencuar.

Neni 12

Për ushtrimin e veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese

1. Personi fizik për ushtrimin e veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese do të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin e autodeklarimit;

b) *Curriculum Vitae* (CV) e detajuar e tij;

c) Diplomën e mbarimit të shkollës së lartë (navigator, inxhinier naval, arkitekti naval ose inxhinier mekanik naval);

d) Dokument nga një institucion shtetëror që vërteton eksperiencë pune prej të paktën 5 vjetësh në fushat e përmendura në pikën 4.

2. Personi juridik që do të licencohet në fushën e veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese, duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, si dhe kontratat e punës meurvejorët e punësuar.



KREU V
PEZULLIMI DHE REVOKIMI I
LICENCEVE

Neni 13

Pezullimi

1. Licencat për veprimtaritë në shërbimet portuale detar pezullohen, kur:

a) Subjekti nuk respekton kriteret për të cilat i është dhënë titulli (licencës);

b) Nuk respekton detyrimet kontraktuale;

c) Nuk zbaton detyrimet e Kodit Detar dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore.

2. Konstatimi i mospërmbushjes së kriterëve dhe mosrespektimi i detyrimeve të dhënies së licencës bëhet nga kapitaneria e portit që menaxhon lundrimin detar.

3. Pas konstatimit, kapitaneria pezullon licencën dhe njofton subjektin për përmbushjen e kriterëve apo detyrimeve, brenda një afati jo më shumë se 30 ditë.

4. Kur vendoset pezullimi i aktivitetit të subjektit, lajmërohet menjëherë zyrtarisht ministria përgjegjëse për transportin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar, arsyet që e kanë çuar për të dhënë urdhrin e pezullimit dhe publikohet vendimi i pezullimit në regjistrin kombëtar të licencave, autorizimeve dhe lejeve.

5. Vendimi për pezullimin e licencës, revokohet ose lihet në fuqi nga ministria përgjegjëse për transportin detar, sipas legjislacionit në fuqi pas kërkesës zyrtare nga i interesuari (operatori ose organi kompetent), kur verifikohet dhe vlerësohet se subjekti i ka plotësuar ose jo të gjitha detyrimet, sipas rastit ose kur vërehet se urdhri i pezullimit nuk ka qenë në proporcion me shkeljen. Vendimi i pezullimit publikohet në regjistrin kombëtar të licencave, autorizimeve dhe lejeve.

Neni 14

Revokimi

1. Licencat revokohen nga ministria përgjegjëse për transportin, pas propozimit nga porti detar ku ushtrohet aktiviteti ose nga kapitaneria e portit, në rastet si më poshtë:

a) Kur subjekti nuk përmbush më kriteret për të cilat është dhënë licenca;

b) Kur subjekti nuk zbaton të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në aktin e miratimit;

c) Kur vërtetohet se personat juridikë/fizikë kanë paraqitur deklaratime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës për të cilën kanë aplikuar, si edhe gjatë ushtrimit të aktivitetit;

d) Për mosplotësimin e kushteve edhe pas vendimmarrjes së pezullimi;

e) Me kërkesë nga autoriteti përkatës për moszbatim të kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim edhe pas njoftimeve dhe afateve të lëna;

f) Me kërkesë nga kapitaneria e portit, për moszbatimin në mënyrë të përsëritur të rregullave dhe urdhrave të kapitanerisë;

g) Në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga subjekti kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik;

2. Vendimi i revokimit publikohet në regjistrin kombëtar të licencave, autorizimeve dhe lejeve nga organi përgjegjës për revokimin e licencës;

3. Nëse licenca revokohet si rezultat i një prej shkeljeve e mësipërme, personat juridikë/fizikë nuk pajisen me licencë veprimtarie për një periudhë deri 3 (tre) vjet.

Neni 15

Dispozita tranzitore dhe të fundit

1. Licencat e dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 10, datë 23.6.2008, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, i ndryshuar, do të vazhdojnë të jenë në fuqi brenda afatit të tyre të vlefshmërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto



Data _____

AUTODEKLARIM
(Për ushtrimin e veprimtarisë së Pilotimit)

Unë i nënshkruari _____ person fizik me NUIS/NIPT _____ ose administrator përfaqësues i shoqërisë _____ me NUIS/NIPT _____ me seli në adresën _____, qyteti _____, me tel _____, Cel. _____, dokument identifikimi) _____

Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plote të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

- Personi fizik/shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur, nuk është në ndjekje penale nga organet e prokurorisë dhe nuk është shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të fushës së detarisë;

- Personi fizik/shoqëria _____ e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS/NIPT _____, regjistruar në Regjistrin Kombëtar pranë QKR nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie aktiviteti për të cilin kërkon të licencohet; nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj asnjë institucioni shtetëror.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.
- Kam në përdorim veshje fosforeshente në të cilën të shkruhet fjala “PILOT” dhe më poshtë emrin e operatorit, radiomarrëse, pajisje personale shpëtimi etj. të cilat do t'i përdor gjatë ushtrimit të aktivitetit.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, firmë)



Data _____

AUTODEKLARIM

(Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Portin e Durrësit, Porto Romanos dhe në Radat përkatëse)

Unë i nënshkruari _____ person fizik me NUIS/NIPT _____ ose administrator përfaqësues i shoqërisë _____ me NUIS/NIPT _____ me seli në adresën _____, qyteti _____, me tel _____, Cel. _____, dokument identifikimi) _____

Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plote të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

- Personi fizik/shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur, nuk është në ndjekje penale nga organet e prokurorisë dhe nuk është shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të fushës së detarisë;

- Personi fizik/shoqëria _____ e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS/NIPT _____, regjistruar në Regjistrin Kombëtar pranë QKR nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie aktiviteti për të cilin kërkon të licencohet; nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj asnjë institucioni shtetëror.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.
- Mjetet (lundruese dhe tokësore) që shërbejnë për ushtrimin e aktivitetit kanë të vendosur në një vend të dukshëm emrin dhe/ose logon e kompanisë.
- Personeli i punësuar për ushtrimin e aktivitetit është i pajisur me pajisjet e nevojshme për mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit, në të cilën dallohen qartë logo dhe/ose emri i shoqërisë, dhe është i aftë për menaxhimin e rasteve emergjente dhe luftën kundër zjarrit.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, firmë)



Formular 1

Data _____

AUTODEKLARIM

(Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e tjera dhe në radat përkatëse)

Unë i nënshkruari _____ person fizik me NUIS/NIPT _____ ose administrator përfaqësues i shoqërisë _____ me NUIS/NIPT _____ me seli në adresën _____, qyteti _____, me tel _____, Cel. _____, dokument identifikimi) _____

Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plote të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

- Personi fizik/shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur, nuk është në ndjekje penale nga organet e prokurorisë dhe nuk është shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të fushës së detarisë;

- Personi fizik/shoqëria _____ e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS/NIPT _____, regjistruar në Regjistrin Kombëtar pranë QKR nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie aktiviteti për të cilin kërkon të licencohet; nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj asnjë institucioni shtetëror.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.
- Mjetet (lundruese dhe tokësore) që shërbejnë për ushtrimin e aktivitetit kanë të vendosur në një vend të dukshëm emrin dhe/ose logon e kompanisë.
- Personeli i punësuar për ushtrimin e aktivitetit është i pajisur me pajisjet e nevojshme për mbrojtjen e jetës, pronës dhe mjedisit, në të cilën dallohen qartë logo dhe/ose emri i shoqërisë, dhe është i aftë për menaxhimin e rasteve emergjente dhe luftën kundër zjarrit.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, firmë)



Data _____

AUTODEKLARIM**Për ushtrimin e veprimtarisë të Stacionit të Shërbimit të Pajisjeve të Sigurimit të Jetës në Det**

Unë i nënshkruari _____ person fizik me NUIS/NIPT _____ ose administrator përfaqësues i shoqërisë _____ me NUIS/NIPT _____ me seli në adresën _____, qyteti _____, me tel _____, Cel. _____, dokument identifikimi) _____

Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plote të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

- Personi fizik/shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur, nuk është në ndjekje penale nga organet e prokurorisë dhe nuk është shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të fushës së detarisë;

- Personi fizik/shoqëria _____ e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS/NIPT _____, regjistruar në Regjistrin Kombëtar pranë QKR nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie aktiviteti për të cilin kërkon të licencohet; nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj asnjë institucioni shtetëror.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, firmë)



Data _____

AUTODEKLARIM
Për ushtrimin e veprimtarisë së Survejimit të Mjeteve Lundruese

Unë i nënshkruari _____ person fizik me NUIS/NIPT _____ ose administrator përfaqësues i shoqërisë _____ me NUIS/NIPT _____ me seli në adresën _____, qyteti _____, me tel _____, Cel. _____, dokument identifikimi) _____

Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plote të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

- Personi fizik/shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur, nuk është në ndjekje penale nga organet e prokurorisë dhe nuk është shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të fushës së detarisë;

- Personi fizik/shoqëria _____ e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS/NIPT _____, regjistruar në Regjistrin Kombëtar pranë QKR nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie aktiviteti për të cilin kërkon të licencohet; nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj asnjë institucioni shtetëror.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, firmë)



Data _____

AUTODEKLARIM
Për ushtrimin e veprimtarisë të ormexhimit

Unë i nënshkruari _____ person fizik me NUIS/NIPT _____ ose administrator përfaqësues i shoqërisë _____ me NUIS/NIPT _____ me seli në adresën _____, qyteti _____, me tel _____, Cel. _____, dokument identifikimi) _____

Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plote të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

- Personi fizik/shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur, nuk është në ndjekje penale nga organet e prokurorisë dhe nuk është shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të fushës së detarisë;

- Personi fizik/shoqëria _____ e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS/NIPT _____, regjistruar në Regjistrin Kombëtar pranë QKR nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie aktiviteti për të cilin kërkon të licencohet; nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj asnjë institucioni shtetëror.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin;
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi;
- Di të notoj;
- Kam në përdorim pajisjet e nevojshme personale si veshje me logon/emrin e subjektit, pajisje dhe veshje fosforeshente, elektrik dore, gaxhaman, radiomarrëse, kaskë etj.;

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, firmë)

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë